

VENDIM
Nr. 511, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË SË FINANCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë së Financave është arritja e stabilitetit ekonomik, nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të financave publike.

3. Ministria e Financave e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

- a) politikën makrofiskale;
- b) administrimin e të ardhurave;
- c) administrimin e buxhetit të shtetit;
- ç) menaxhimin e borxhit publik dhe garancive shtetërore të huas;
- d) administrimin financiar;
- dh) menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- e) menaxhimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian;
- ë) inspektimin financiar publik;
- f) bashkërendimin e përgjithshëm të auditimit të brendshëm;
- g) parandalimin e pastrimit të parave dhe terrorizmit;
- gj) lojërat e fatit;
- h) aksesin në instrumentet financiare dhe lehtësimin e qasjes në financime për sektorët e nënfinancuar;
- i) qasjen në instrumentet e sigurimit dhe risigurimit për risqet që lindin nga fatkeqësitë natyrore.

4. Ministria e Financave, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 3 të këtij vendimi, është përgjegjëse, për:

a) hartimin dhe zbatimin e politikave fiskale e buxhetore, në të cilat përfshihen analizat makrofiskale, parashikimi i të ardhurave, politika e shpenzimeve publike, politika e tatim-taksave, politika e borxhit publik;

b) mbikëqyrjen dhe ndërmarrjen e nismave e të hapave ligjorë, me qëllim administrimin e të ardhurave, në të cilat përfshihen, kryesisht, administrimi i taksave dhe administrimi doganor;

c) hartimin e politikave për miradministrimin e buxhetit, në të cilat përfshihen planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, kontrolli i menaxhimit të investimeve publike, monitorimi i marrëdhënieve financiare ndërqeveritare, kontrolli financiar i transaksioneve publike dhe hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë;

ç) menaxhimin e borxhit publik, në të cilin përfshihen menaxhimi i portofolit të huamarrjes së brendshme e të huaj, menaxhimi i riskut të huamarrjes, si dhe shërbimi i regjistrimit të borxhit;

d) ngritjen e një sistemi modern të menaxhimit financiar e të kontrollit në të gjitha njësitë e sektorit publik nëpërmjet vendosjes së rregullave, standardeve, procedurave dhe monitorimit të zbatimit të tyre;

dh) miradministrimin financiar të fondeve publike, i cili realizohet nëpërmjet ushtrimit të funksionit të thesarit, zbatimit të metodologjisë së kontabilitetit në sektorin publik dhe kontrollit të brendshëm financiar publik;

e) menaxhimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian, sigurimin e bashkëfinancimit, ndjekjen e zbatimit të kontratave, legjitimitetin dhe rregullsinë e transaksioneve të ekzekutuara brenda sistemit të menaxhimit të decentralizuar, si dhe funksionimin e efektshëm të sistemeve të menaxhimit të kontrollit, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA);

ë) inspektimin financiar publik, si funksion i parashikuar, me qëllim:

i. mbrojtjen e interesave financiare të njësive publike kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit dhe korrupsionit;

ii. rregullshmërinë e transaksioneve e të veprimtarive të tjera të menaxhimit financiar publik;

iii. përcaktimin e shkeljeve të akteve normative, si dhe dyshimeve për mashtrimet e kryera;

iv. zbulimin e parregullsive e të dëmeve të shkaktuara në pronën e njësive publike;

v. identifikimin e shkeljeve e të individëve përgjegjës për parregullsitë e zbuluara.

5. Ministria e Financave është institucioni i vetëm që bën bashkërendimin e përgjithshëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm nëpërmjet hartimit dhe miratimit të politikave, manualeve, metodave, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditit të brendshëm.

6. Ministria e Financave ka rol të përgjithshëm këshillues në interes të politikave qeveritare për promovimin e efektshmërisë, performancës së lartë dhe mirëqeverisjes financiare në të gjithë sektorin publik dhe në ato institucione financiare në të cilat qeveria merr pjesë.

7. Vendimi nr. 31, datë 17.1.2024, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave”, shfuqizohet.

8. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama